



KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 19, datë 27.05.2021

**“Mbi shqyrtimin dhe miratimin e raportit përmbledhës të
PricewaterhouseCoopers Consulting sh.p.k. për auditimin e brendshëm
të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave
për vitin 2020”**

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 52, pika 1, shkronja “j” dhe të nenit 63, pika 2 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 18, pika 1 dhe pika 4 të Statutit të Agjencisë, të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 17 të Rregullores “Për kartën e auditimit të brendshëm në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të miratuar me Vendimin Qarkullues të Këshillit Drejtues të Agjencisë nr. 16, datë 30.04.2020, si dhe të nenit 18 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, me propozim të Audituesit të Brendshëm, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Miratimin e raportit të PricewaterhouseCoopers Consulting sh.p.k. për auditimin e brendshëm të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2020, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen njësitë organizative të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar